



Nr. I prot 507 Më 14.02.2023
Dhënie e pronës së paluajtshme të Komunes Nr. 06/1-092

Mbështetur në Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunes Nr. 06/1-092 e datës 07.03.2019, në Rregulloren QRK Nr.09/2020 të datës 10.08.2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, neni 34, pika 5 të rregullores komunale për taksa komunale, 01/80 të datës: 29.06.2020, si dhe vendimeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit, 01Nr. 1762/18, të datës 30.05.2018.Komisioni Vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim i caktuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, 01Nr12/23, dt. 30.01.2023 shpallë këtë:

NJOFTIM RISHPALLJE PËR ANKAND PUBLIK

PËR DHËNIE E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR

Njoftim publik për dhënie e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës, përmban si në vijim:

- Parcela Kadastrale nr. P- 71510057-03710-0, ne sipërfaqe të përgjithshme 616 m2 , PSH e Kosovës, KK Rahovec, me kulture kullose e Klasës 3, që gjendet në vendin e quajtur " Nashpal" ZK Rahovec.

Afati i dhënies në shfrytëzim:

Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është afatshkurtër prej dhjetë (10) vitesh.

Veprimtaria që ushtrohet sipas destinimit të pronës:

Shfrytëzimi i pronës së marrë në shfrytëzim mund të shërbej vetëm për qëllime bujqësore.

Çmimi fillestar i pronës që është objekt i dhënies në shfrytëzim përmes ankandit.

Çmimi fillestar për dhënien e pronës në shfrytëzim të tokës bujqësore është i përcaktuar sipas Nenit 34, pika 5.2 të rregullores komunale për taksa komunale, 01/80 të datës 29.06.2020 për dhënien në shfrytëzim të tokës bujqësore.

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara.

Dokumentacioni për ofertim tërhiqet në zyrën e prokurimit në Rahovec nga data: **14.02.2023**, deri me datë: **28.02.2023** në ora: **15:00 h**.

Aplikimi bëhet në zyrën e Prokurimit, çdo ditë pune **(08:00)h deri (16:00)**.

Vendi, koha ku do të mbahet ankandi publik:

Në sallën e Kuvendit Komunal, me datën 02.03.2023 në fillim në ora: **14:00**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik;

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik,

- Personat fizik krahas aplikacionit në kuvertë duhet të ofrojnë edhe kopjen e letërnjoftimit dhe dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë për gjashtëmujorit të dytë të vitit 2022.
- Personat juridik, krahas aplikacionit në kuvertë duhet ta bashkëngjisin
 - I. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi biznesin.
 - II. Vërtetimin e taksës komunale në afarizëm,
 - III. Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës,
 - IV. Vërtetimin e tatimit në pronë për periudhën e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2022.

Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohej e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik,
- Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim,
- Kanë qasje në dokumentacionet e pronës,
- Tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
- Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmojnë si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës;

- Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
- Raporti përfundimtar i Komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:
 - Një kopje të shpalljes së ankandit publik;
 - Procesverbalin e procesit të ankandit publik;
 - Rekomandimin e Komisionit për zgjedhjen e fituesit;
 - Një kopje të protokolliuar të ofertës së përzgjedhur;
 - Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në ankand publik.
- Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i

njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar në pliko të mbyllura do të shpallet fitues gjatë procesit të hapjes së ofertave.

- Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afat prej shtatë (7) ditësh.
- Nëse komisioni i ankesave konstaton se ka shkelje gjatë procesit të vlerësimit ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e procesit, por nëse komisioni i ankesave vlerëson se nuk ka bazë, atëherë ankesën e refuzon si të pabazuar.
- Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e komisionit vlerësues.

Vërejtje:

Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim në ankand publik bëhet në formë fizike në zyrën e prokurimit në Rahovec.

Rahovec: 14.02.2023

Komisioni vlerësues i Ofertave